



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.4

13 shkurt

2012

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.80, datë 12.2.2012	Për shpalljen e gjendjes së emergjencës civile (fatkeqësisë natyrore) në njësitë e qeverisjes vendore të qarqeve Shkodër, Kukës, Dibër, Korçë dhe rrethin e Librazhdit.....	111
Udhëzim i MPPT nr.1, datë 18.1.2012	Për dokumentet e qarkullimit dhe të regjistrimit të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre	112

VENDIM
Nr.80, datë 12.2.2012

**PËR SHPALLJEN E GJENDJES SË EMERGJENCËS CIVILE (FATKEQËSISË NAYRORE)
NË NJËSITË E QEVERISJES VENDORE TË QARQEVE SHKODËR, KUKËS, DIBËR,
KORÇË DHE RRETHIN E LIBRAZHBIT**

Në mbështetje të neneve 100 e 174 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 2 shkronja “c”, e 6 të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen e gjendjes së emergjencës civile (fatkeqësisë natyrore), si pasojë e përkeqësimit të kushteve natyrore të motit në njësitë e qeverisjes vendore të qarqeve Shkodër, Kukës, Dibër, Korçë dhe rrethin e Librazhdit.

2. Ngritjen e Komitetit Ndërmintor të Emergjencave Civile, i cili të kryesohet nga Kryeministri dhe në përbërje të ketë këta anëtarë:

- Ministrin e Brendshëm;
- Ministrin e Mbrojtjes;
- Ministrin e Financave;
- Ministrin e Punëve Publike dhe Transportit;
- Ministrin e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit;
- Ministrin e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës;
- Ministrin e Shëndetësisë;
- Ministrin e Arsimit dhe Shkencës;
- Ministrin e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave;
- Shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura;
- Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit;
- Drejtorin e Përgjithshëm të Emergjencave Civile.

3. Komiteti Ndërmintor i Emergjencave civile të bashkërendojë punën me ministritë e linjës, me institucionet qendrore e rajonale, në varësi të ministrive të linjës, me institucionin e prefektit të qarqeve Shkodër, Kukës, Dibër, Korçë dhe nënprefektin e Librazhdit, si dhe me të gjitha njësitë e qeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e emergjencës civile, për zbatimin e detyrave në varësi të situatës, për garantimin e sigurisë së jetës të banorëve, për sigurimin e veprimtarisë normale për jetesë të komuniteteve të prekura në këto zona, si dhe për marrjen e masave parandaluese, mbrojtëse e rehabilituese në infrastrukturën dhe mjedisin e prekur nga situata e krijuar.

4. Ngarkohen Komiteti Ndërmintor i Emergjencave Civile, Ministri i Brendshëm, ministritë e linjës, prefektët e qarqeve Shkodër, Kukës, Dibër, Korçë dhe nënprefekti i Librazhdit, si dhe njësitë e qeverisjes vendore përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



UDHËZIM
Nr.1, datë 18.1.2012

PËR DOKUMENTET E QARKULLIMIT DHE TË REGJISTRIMIT TË MJETEVE
RRUGORE ME MOTOR DHE RIMORKIOVE TË TYRE

Në mbështetje të pikës 4, neni 102 të kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 92-102 dhe 220-224 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe neneve 237-252, 368 dhe 370 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.153, datë 7.4.2000 “Rregullorja e zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit

UDHËZON:

KREU I
AUTOMJETET, MOTOMJETET DHE RIMORKIOT

I. REGJISTRIMI I PARË

Neni 1

Regjistrimi i automjeteve, motomjeteve dhe rimorkiove

1. Automjetet, motomjetet dhe rimorkiot për të qarkulluar duhet të jenë të pajisura me një leje qarkullimi dhe të jenë të regjistruara pranë drejtorive rajonale përkatëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR).

2. Me regjistrim të mjetit kuptohet kërkesa për aplikim nga subjekti fizik ose juridik, kontrolli fizik i mjetit, pranimi i dokumentacionit, leximi automatik dhe/ose manual, si dhe evidentimi i të dhënave, lëshimi i lejes së qarkullimit dhe targës së mjetit.

3. Regjistrimi i të dhënave të mjeteve dhe pronarëve bëhet në regjistrin elektronik kombëtar, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 5 të këtij udhëzimi.

Neni 2

Kontrolli fizik i mjetit

1. Aplikimi për regjistrimin e mjetit fillon me kryerjen e kontrollit fizik.

2. Kontrolli fizik i mjetit përmbledh:

a) leximin dhe përcaktimin e saktë të të dhënave mbi identifikimin e mjetit, bazë e të cilit është numri i identifikimit i stampuar në shasi;

b) leximin automatik dhe/ose manual, si dhe përcaktimin e saktë të karakteristikave teknike të mjetit sipas normave dhe standardeve ndërkombëtare e europiane të përcaktuara në rregulloret e DPSHTRR-së, në zbatim të këtij udhëzimi;

c) evidentimin e të dhënave të lartpërmendura në regjistrin elektronik të kontrollit fizik, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;

d) plotësimin e të dhënave në certifikatën e kontrollit fizik të mjetit, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;

e) fotografi digjitale për mjetin, sipas përcaktimeve në rregulloren e DPSHTRR-së, në zbatim të këtij udhëzimi.

3. Në rastet kur konstatohen parregullsi, dëmtime, mungesë e numrit të identifikimit apo mungesë e tabelës identifikuese, bëhet fotografimi i numrit të identifikimit të stampuar në shasi.

4. Për rastet e përmendura në pikën 3 të këtij neni, në regjistër dhe në certifikatën e kontrollit fizik vendoset shënimi përkatës sipas rastit të konstatuar.

5. Për mjetet e prodhuara në vend, kur konstatohet mungesa e numrit të identifikimit, në regjistër dhe në certifikatën e kontrollit fizik vendoset shënimi “Mjet i prodhuar në vend, numri i identifikimit mungon”.

6. Drejtoritë rajonale të shërbimeve të transportit rrugor kryejnë kontrollin fizik të mjeteve me dy specialistë të saj, të cilët plotësojnë kushtet e përcaktuara në pikën 1 dhe 2 të nenit 80 të Kodit Rrugor.

7. Kontrolli fizik kryhet detyrimisht për të gjitha llojet e shërbimeve që përcaktohen në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, në fushën e regjistrimit të mjeteve, pjesë e këtij udhëzimi. Përrjashtim bëjnë rastet e parashikuara në nenet 16, 18, 20, 21, 35, 42, 46 dhe 47.

Neni 3

Dokumentacioni i nevojshëm për regjistrim

1. Dokumentacioni i nevojshëm për të regjistruar mjetet e reja, të blera jashtë shtetit:

a) Dokumenti i fitimit të pronësisë, sipas legjislacionit përkatës, me anë të të cilit është fituar pronësia e mjetit.

Me formë të fitimit të pronësisë do të kuptojmë:

- faturë dhe, ose kontratë të fitimit të pronësisë;
- aktin e trashëgimisë për fitimin e pronësisë.

b) Dokumenti teknik i origjinës së mjetit, i lëshuar nga prodhuesi ose agjencia e shitjes, e ngarkuar prej tij, në origjinal (certifikata e përputhjes).

c) Dokumenti i zhdoganimit nga autoriteti shqiptar, që nënkupton:

- dokumentin administrativ të vetëm DAV në origjinal.

2. Dokumentacioni i nevojshëm për të regjistruar mjetet e reja, të blera në vend:

a) Dokumenti i fitimit të pronësisë, sipas formës dhe mënyrës që parashikon Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë. Nëse shitësi është subjekt i TVSH-së, si dokument i fitimit të pronësisë duhet edhe fatura me TVSH.

b) Dokumenti teknik i origjinës së mjetit, i lëshuar nga prodhuesi ose agjencia e shitjes, e ngarkuar prej tij, në origjinal (certifikata e përputhjes).

c) Dokumenti i zhdoganimit nga autoriteti shqiptar, si në pikën 1 shkronja “c” të këtij neni.

3. Dokumentacioni i nevojshëm për të regjistruar mjetet e përdorura, të blera jashtë shtetit:

a) Dokumenti i fitimit të pronësisë, si në pikën 1 shkronja “a” të këtij neni.

b) Dokumentet shoqëruese me treguesit teknikë dhe të pronësisë së mjetit, të lëshuara nga organet zyrtare të shtetit nga vjen mjeti, në origjinal.

c) Dokumenti i zhdoganimit nga autoriteti shqiptar, si në pikën 1 shkronja “c” të këtij neni.

4. Dokumentacioni i nevojshëm për të regjistruar mjetet e përdorura, të blera në vend:

a) Dokumenti i fitimit të pronësisë, sipas formës dhe mënyrës që parashikon Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë. Nëse shitësi është subjekt i TVSH-së, si dokument i fitimit të pronësisë duhet edhe fatura me TVSH.

b) Dokumentet shoqëruese me treguesit teknikë dhe të pronësisë së mjetit, të lëshuara nga organet zyrtare të shtetit nga vjen mjeti, në origjinal.

c) Dokumenti i zhdoganimit nga autoriteti shqiptar, si në pikën 1 shkronja “c” të këtij neni.

5. DPSHTRR-ja në vazhdimësi, të sigurojë modelet e dokumenteve teknike të origjinës së mjetit, të lëshuara nga prodhuesi ose agjencitë e shitjes së ngarkuar prej tij dhe të dokumenteve shoqëruese, prejardhëse, me treguesit teknikë të mjetit. Modelet e siguruara do të shërbejnë si ekzemplarë për pranimin e dokumenteve të mësipërme.



6. Personi i interesuar, që do të kuptohet individ, subjekti ose përfaqësuesi ligjor i tyre, paraqet:

a) aplikimin pranë drejtorisë rajonale për shërbimin e kërkuar, i cili përmban dhe deklaratën e marrjes së përgjegjësive administrative, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;

b) për subjektet, ekstrakt i QKR-së në origjinal dhe autorizim për personin që do të kryejë veprimet, nëse nuk është përfaqësuesi ligjor i subjektit;

c) kartën e identitetit, e cila pasi fotokopjohet dhe legalizohet nga nëpunësi i pranimit sipas rregullave në fuqi, i kthehet përsëri aplikuesit; Për shtetasit e huaj, rezidentë në Shqipëri, duhet leja e qëndrimit e lëshuar nga organet kompetente të Ministrisë së Brendshme, fotokopje e noterizuar.

7. Dokumentet e lartpërmendura, që janë në gjuhë të huaj, duhet të jenë të përkthyer në shqip dhe të noterizuara.

Neni 4

Pranimi i dokumentacionit

1. Personi i interesuar dorëzon pranë zyrave të regjistrimit në drejtoritë rajonale të shërbimeve të transportit rrugor, sipas rastit dokumentacionin e përmendur në nenin 2 dhe 3 të këtij udhëzimi.

2. Zyra e regjistrimit pranon dokumentacionin kur ai është i rregullt dhe në përputhje me modelet e siguruar nga DPSHTRR-ja, dhe të dhënat e kontrollit fizik të mjetit përputhen me të dhënat dhe dokumentacionin shoqërues të tij. Në të kundërt, dokumentacioni i kthehet personit, së bashku me “Procesverbalin e refuzimit të shërbimit”, ku përcaktohen saktë arsyet e mospranimit.

Neni 5

Evidentimi i të dhënave

1. Të dhënat e mjetit dhe të personit të interesuar, evidentohen në:

a) regjistrin elektronik të mjeteve, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;

b) kartelën elektronike të mjetit, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;

c) lejen e qarkullimit të mjetit, model DRM-04, bashkëlidhur këtij udhëzimi;

d) programin informatik të mjeteve në kompjuter.

2. Me dokumentacionin e dorëzuar, krijohet dosja e mjetit, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja, e cila sistemohet në arkiv.

3. Kartela elektronike, pas çdo veprimi me mjetin, printohet dhe bashkëngjitet me dokumentet e tjera në dosje, pasi të jetë nënshkruar nga punonjësi i pranimit që bën veprimin.

Neni 6

Lëshimi i lejes së qarkullimit dhe targës

Mbas evidentimit të të dhënave, zyra e regjistrimit i lëshon brenda kohës së aplikimit personit të interesuar lejen e qarkullimit dhe targat e mjetit.

Neni 7

Lëshimi i targës përsëritëse

1. Në rastet kur kërkohet targë përsëritëse, për karrel ose rimorkio me një aks që i montohet një mjeti, personi i interesuar dorëzon:

a) aplikimin pranë drejtorisë rajonale për shërbimin e kërkuar, i cili përmban dhe deklaratën e marrjes së përgjegjësive administrative, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;

b) kartën e identitetit, e cila pasi fotokopjohet dhe legalizohet nga nëpunësi i pranimit sipas rregullave në fuqi, i kthehet përsëri aplikuesit;

c) dokumentin e fitimit të pronësisë, me njërën nga format që parashikon Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë;

d) dokumentin e origjinës së mjetit të ri, të lëshuar nga prodhuesi apo agjencia e shitjes, e ngarkuar prej tij, ose dokumentin shoqërues, prejardhës, me treguesit teknikë të mjetit të përdorur, në origjinal;

e) dokumentin e zhdoganimit nga autoriteti shqiptar.

2. Zyra e regjistrimit:

a) bën ndryshimet në regjistrin elektronik, kartelën përkatëse dhe në programin informatik të mjeteve;

b) shënon të dhënat e mjetit shtojcë në lejen e qarkullimit të mjetit tërheqës;

c) lëshon, brenda kohës së aplikimit, targën përsëritëse, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.724, datë 1.9.2010 të njëjtë me atë të mjetit tërheqës;

d) me dokumentet e dorëzuara, krijohet fashikulli, i cili futet në dosjen e mjetit tërheqës.

Neni 8

Lëshimi i certifikatës së pronësisë së mjetit

1. Për mjetet e regjistruara, drejtoria rajonale e shërbimeve të transportit rrugor bën verifikimet në zbatim të pikës 3 të nenit 237 të rregullores në zbatim të Kodit Rrugor.

2. Pas verifikimit, kur mjetet rezultojnë:

a) të rregullta, plotësohen të dhënat e pronarit në regjistrin elektronik dhe lëshohet certifikata e pronësisë së mjetit, model DRM-05, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

b) të parregullta, veprohet sipas nenit 216 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”.

II. NDRYSHIMET NË REGJISTËR

Neni 9

Ndryshimi i të dhënave

Ndryshimet në regjistër kanë të bëjnë me azhurnimin e të dhënave të:

a) dokumentacionit;

b) mjetit.

Neni 10

Azhurnimi i të dhënave të dokumentacionit

Azhurnimi i të dhënave të dokumentacionit bëhet kur:

a) ndryshon vendbanimi i pronarit të mjetit;

b) ndryshojnë gjeneralitetet e pronarit të mjetit;

c) ndryshon pronësia mbi mjetin;

d) humbet, vidhet, shkatërrohet ose dëmtohet leja e qarkullimit të mjetit;

e) humbet, vidhet, shkatërrohet ose dëmtohet targa;

f) humbet, vidhet, shkatërrohet ose dëmtohet certifikata e pronësisë së mjetit.



Neni 11

Ndryshimi i vendbanimit të pronarit të mjetit

1. Kur pronari i mjetit ndryshon vendbanimin, ai dorëzon në zyrën e regjistrimit të drejtorisë rajonale që ka nën juridiksionin e saj vendbanimin e ri:

a) aplikimin pranë drejtorisë rajonale për shërbimin e kërkuar, i cili përmban dhe deklaratën e marrjes së përgjegjësive administrative, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;

b) kartën e identitetit, e cila pasi fotokopjohet dhe legalizohet nga nëpunësi i pranimit sipas rregullave në fuqi, i kthehet përsëri aplikuesit;

c) lejen e qarkullimit të mjetit;

d) certifikatën e pronësisë së mjetit;

e) kur pronari ndryshon rrethin e vendbanimit, dorëzon targat vetëm nëse ato janë të sistemit të vjetër. Nuk dorëzohen targat, nëse janë të sistemit të ri, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.724, datë 1.9.2010.

2. Kur pronari ndryshon vendbanimin brenda rrethit, zyra e regjistrimit:

a) bën ndryshimet në regjistrin elektronik, kartelën përkatëse dhe në programin informatik të mjeteve;

b) me dokumentet e dorëzuara krijohet fashikulli sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja, që futet në dosjen përkatëse të mjetit;

c) plotëson dhe lëshon lejen e re të qarkullimit të mjetit;

d) bën ndryshimet në certifikatën e pronësisë së mjetit.

3. Kur pronari ndryshon vendbanimin brenda rretheve që ka nën juridiksion drejtoria rajonale, zyra e regjistrimit:

a) bën ndryshimet në regjistrin elektronik, kartelën përkatëse dhe në programin informatik të mjeteve;

b) sipas procedurave të miratuara nga DPSHTRR-ja, magazinon targat, nëse ato janë sipas sistemit të vjetër;

c) me dokumentet e dorëzuara, krijohet fashikulli sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja që futet në dosjen përkatëse të mjetit;

d) plotëson dhe lëshon lejen e re të qarkullimit të mjetit;

e) i dorëzon aplikantit targat e reja të mjetit, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.724, datë 1.9.2010 në rastet kur ky i fundit ka pasur targa të sistemit të vjetër;

f) bën ndryshimet në certifikatën e pronësisë së mjetit.

4. Kur pronari ndryshon vendbanimin jashtë juridiksionit të drejtorisë rajonale, zyra e regjistrimit e drejtorisë rajonale që ka nën juridiksion vendbanimin e ri:

a) depoziton certifikatën e kontrollit fizik të mjetit, që kryhet sipas procedurave të përcaktuara në nenin 2 të këtij udhëzimi;

b) i bën kërkesë drejtorisë rajonale, ku mjeti është i regjistruar, për transferimin e dosjes së mjetit, sipas modelit të përcaktuar nga DPSHTRR-ja;

c) bën ndryshimet në regjistrin elektronik, kartelën përkatëse dhe në programin informatik të mjeteve;

d) sipas procedurave të miratuara nga DPSHTRR-ja, magazinon targat e mjetit, nëse ato janë sipas sistemit të vjetër;

e) plotëson dhe lëshon lejen e re të qarkullimit të mjetit;

f) i dorëzon aplikantit targat e reja të mjetit, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.724, datë 1.9.2010 në rastet kur ky i fundit ka pasur targa të sistemit të vjetër;

g) merr nga drejtoria rajonale, ku mjeti ka qenë i regjistruar, dosjen dhe vërtetimin e çregjistrimit të mjetit, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;

h) me dokumentet e dorëzuara, krijohet fashikulli sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja, që futet në dosjen përkatëse të mjetit;

i) bën ndryshimet në certifikatën e pronësisë së mjetit.

5. Për të gjitha rastet kur ka mospërputhje të të dhënave, veprohet sipas nenit 216 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”.

Neni 12

Ndryshimet e gjeneraliteteve të pronarit të mjetit

Nëse pronari i mjetit ndryshon gjeneralitetet, veprohet njëjloj si në pikën 1 (pa marrë në konsideratë shkronjën “e” dhe pikën 2 të nenit 11 të këtij udhëzimi.

Neni 13

Ndryshimi i pronësisë

1. Kur ndryshon pronësia mbi mjetin, personi i interesuar dorëzon në zyrën e regjistrimit të drejtorisë rajonale që ka nën juridiksionin e saj vendbanimin e tij:

a) aplikimin pranë drejtorisë rajonale për shërbimin e kërkuar, i cili përmban dhe deklaratën e marrjes së përgjegjësive administrative, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;

b) dokumentin e fitimit të pronësisë së mjetit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, në origjinal, së bashku me konfirmimin nga Regjistri i Barrëve Siguruese (RBS);

c) lejen e qarkullimit të mjetit;

d) certifikatën e pronësisë së mjetit;

e) kartën e identitetit, e cila pasi fotokopjohet dhe legalizohet nga nëpunësi i pranimit sipas rregullave në fuqi, i kthehet përsëri aplikantit;

f) kur pronari ndryshon rrethin e vendbanimit, dorëzon targat, vetëm nëse ato janë të sistemit të vjetër.

2. Kur personi i interesuar ka vendbanimin në të njëjtin rreth me pronarin e vjetër, zyra e regjistrimit vepron njëjloj si në pikën 2 të nenit 11.

3. Kur personi i interesuar ka vendbanimin në një rreth tjetër, brenda juridiksionit të drejtorisë rajonale ku mjeti është i regjistruar, zyra e regjistrimit:

a) bën ndryshimet në regjistrin elektronik, kartelën përkatëse dhe në programin informatik të mjeteve;

b) sipas procedurave të miratuara nga DPSHTRR-ja, magazinon targat, nëse ato janë sipas sistemit të vjetër;

c) me dokumentet e dorëzuara, krijohet fashikulli përkatës, i cili sistemohet në dosjen e mjetit.

d) plotëson dhe lëshon lejen e re të qarkullimit të mjetit;

e) plotëson dhe lëshon certifikatën e re të pronësisë së mjetit;

f) i dorëzon aplikantit targat e reja të mjetit, në zbatim të vendimit Këshillit të Ministrave nr.724, datë 1.9.2010 në rastet kur ky i fundit ka pasur targa të sistemit të vjetër.

4. Kur personi i interesuar ka vendbanimin në një rreth jashtë juridiksionit të drejtorisë rajonale ku mjeti është i regjistruar, zyra e regjistrimit e drejtorisë rajonale që ka nën juridiksion vendbanimin e ri:

a) i bën kërkesë drejtorisë rajonale ku mjeti është i regjistruar, për transferimin e dosjes së mjetit, sipas modelit të përcaktuar nga DPSHTRR-ja;

b) merr nga drejtoria rajonale ku mjeti ka qenë i regjistruar, dosjen dhe vërtetimin e çregjistrimit të mjetit;

c) bën ndryshimet në regjistrin elektronik, kartelën përkatëse dhe në programin informatik të mjeteve;



d) sipas procedurave të miratuara nga DPSHTRR-ja, magazinon targat, nëse ato janë sipas sistemit të vjetër;

e) plotëson dhe lëshon lejen e re të qarkullimit të mjetit;

f) i dorëzon aplikantit targat e reja të mjetit, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.724, datë 1.9.2010 në rastet kur ky i fundit ka pasur targa të sistemit të vjetër;

g) Me dokumentet e dorëzuara, krijohet fashikulli përkatës, i cili sistemohet në dosjen e mjetit.

h) Plotëson dhe lëshon certifikatën e re të pronësisë së mjetit.

5. Për të gjitha rastet, kur ka mospërputhje të të dhënave, veprohet sipas nenit 216 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”.

Neni 14

Humbja, vjedhja, shkatërrimi ose dëmtimi i lejes së qarkullimit

1. Në rastet e humbjes ose të vjedhjes së lejes së qarkullimit, personi i interesuar dorëzon:

a) aplikimin pranë drejtorisë rajonale për shërbimin e kërkuar, i cili përmban dhe deklaratën e marrjes së përgjegjësive administrative, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja.

b) vërtetimin e denoncimit, të lëshuar nga organet e policisë.

c) kartën e identitetit, e cila pasi fotokopjohet dhe legalizohet nga nëpunësi i pranimit sipas rregullave në fuqi, i kthehet përsëri aplikuesit.

2. Zyra e regjistrimit:

a) plotëson regjistrin e lejeve të përkohshme të qarkullimit, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;

b) plotëson dhe lëshon lejen e përkohshme të qarkullimit, model DRM-08, bashkëlidhur këtij udhëzimi, me afat 30 ditë nga data e paraqitjes së vërtetimit të denoncimit;

c) me dokumentet e dorëzuara, krijohet fashikulli përkatës, i cili mbahet në zyrën e regjistrimit.

3. Pasi të kenë kaluar 30 ditë nga data e lëshimit të lejes së përkohshme të qarkullimit, personi i interesuar dorëzon:

a) aplikimin pranë drejtorisë rajonale për shërbimin e kërkuar, në vazhdim të pikës 1 shkronja “a”, të këtij neni;

b) lejen e përkohshme të qarkullimit të mjetit.

4. Zyra e regjistrimit, në rastet kur leja e qarkullimit nuk është gjetur ose dorëzuar brenda afatit prej 30 ditësh:

a) plotëson dhe lëshon lejen e re të qarkullimit të mjetit;

b) bën ndryshimet në regjistrin elektronik, kartelën përkatëse dhe në programin informatik të mjeteve;

c) me dokumentet e dorëzuara, plotësohet fashikulli i krijuar sipas pikës 2 shkronja “c” të këtij neni, i cili sistemohet në dosjen e mjetit.

5. Në rastet e dëmtimit të lejes së qarkullimit (leja e qarkullimit konsiderohet e dëmtuar, kur ajo është bërë e papërdorshme por e identifikueshme) personi i interesuar dorëzon:

a) aplikimin pranë drejtorisë rajonale për shërbimin e kërkuar, i cili përmban dhe deklaratën e marrjes së përgjegjësive administrative, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;

b) lejen e qarkullimit të dëmtuar;

c) kartën e identitetit, e cila pasi fotokopjohet dhe legalizohet nga nëpunësi i pranimit sipas rregullave në fuqi, i kthehet përsëri aplikuesit.

6. Zyra e regjistrimit:

a) plotëson dhe lëshon lejen e qarkullimit të mjetit;

b) bën ndryshimet në regjistrin elektronik, kartelën përkatëse dhe në programin informatik të mjeteve;

c) me dokumentet e dorëzuara, krijohet një fashikull, i cili sistemohet në dosjen e mjetit.

7. Në rastin e shkatërrimit të lejes së qarkullimit, do të veprohet njëjloj si në rastet e humbjes ose vjedhjes.

Neni 15

Humbja, vjedhja, shkatërrimi ose dëmtimi i targës

1. Në rastet e humbjes ose të vjedhjes së targës, personi i interesuar, pas 15 ditëve nga data e lëshimit të vërtetimit të denoncimit, dorëzon:

a) aplikimin pranë drejtorisë rajonale për shërbimin e kërkuar, i cili përmban dhe deklaratën e marrjes së përgjegjësive administrative, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;

b) vërtetimin e denoncimit, të lëshuar nga organet e policisë;

c) lejen e qarkullimit të mjetit;

d) certifikatën e pronësisë së mjetit;

e) targën, kur është denoncuar humbja e njëjës prej tyre;

f) kartën e identitetit, e cila pasi fotokopjohet dhe legalizohet nga nëpunësi i pranimi sipas rregullave në fuqi, i kthehet përsëri aplikuesit.

2. Zyra e regjistrimit:

a) bën ndryshimet në regjistrin elektronik, kartelën përkatëse dhe në programin informatik të mjeteve.

b) magazinon targën;

c) plotëson dhe lëshon lejen e re të qarkullimit të mjetit;

d) plotëson dhe lëshon certifikatën e re të pronësisë së mjetit;

e) lëshon targat e reja të mjetit, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.724, datë 1.9.2010;

f) me dokumentet e dorëzuara, krijohet një fashikull, i cili sistemohet në dosjen e mjetit.

3. Në rastet e dëmtimit të targës (targa konsiderohet e dëmtuar, kur ajo është bërë e palexueshme, por e identifikueshme) personi i interesuar dorëzon:

a) aplikimin pranë drejtorisë rajonale për shërbimin e kërkuar, i cili përmban dhe deklaratën e marrjes së përgjegjësive administrative, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;

b) lejen e qarkullimit të mjetit;

c) certifikatën e pronësisë së mjetit;

d) targat e dëmtuara të mjetit;

e) certifikatën e kontrollit fizik të mjetit, me shënimin përkatës “targë e dëmtuar”;

f) kartën e identitetit, e cila pasi fotokopjohet dhe legalizohet nga nëpunësi i pranimi sipas rregullave në fuqi, i kthehet përsëri aplikuesit.

4. Zyra e regjistrimit veprom njëjloj si në pikën 2 të këtij neni.

5. Në rastin e shkatërrimit të targës, do të veprohet njëjloj si në rastet e humbjes ose vjedhjes.

Neni 16

Humbet, vidhet, shkatërrohet ose dëmtohet certifikata e pronësisë së mjetit

1. Në rastet e humbjes, vjedhjes, shkatërrimit ose dëmtimit të certifikatës së pronësisë së mjetit, personi i interesuar dorëzon:

a) aplikimin pranë drejtorisë rajonale për shërbimin e kërkuar, i cili përmban dhe deklaratën e marrjes së përgjegjësive administrative, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;



b) kartën e identitetit, e cila pasi fotokopjohet dhe legalizohet nga nëpunësi i pranimit sipas rregullave në fuqi, i kthehet përsëri aplikuesit.

2. Zyra e regjistrimit:

a) bën ndryshimet në regjistrin elektronik, kartelën përkatëse dhe në programin informatik të mjeteve;

b) plotëson dhe lëshon certifikatën e re të pronësisë;

c) me dokumentet e dorëzuara, krijohet një fashikull, i cili sistemohet në dosjen e mjetit.

Neni 17

Azhurnimi i të dhënave të mjetit

Azhurnimi i të dhënave të mjetit bëhet kur:

a) modifikohen karakteristikat konstruktive të mjetit;

b) ristampohet numri i identifikimit të mjetit.

Neni 18

Modifikimi i karakteristikave konstruktive të mjetit

1. Me modifikim kuptohet çdo ndryshim i karakteristikave konstruktive të regjistruara të mjetit, për të cilin organi përkatës i DPSHTRR-së lëshon certifikatën e miratimit përfundimtar të ndryshimit, sipas modelit të përcaktuar nga DPSHTRR-ja.

2. Në rastet e modifikimit të mjetit, personi i interesuar dorëzon:

a) aplikimin pranë drejtorisë rajonale për shërbimin e kërkuar, i cili përmban dhe deklaratën e marrjes së përgjegjësive administrative, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;

b) certifikatën e miratimit përfundimtar të ndryshimit;

c) lejen e qarkullimit të mjetit;

d) certifikatën e pronësisë së mjetit;

e) kartën e identitetit, e cila pasi fotokopjohet dhe legalizohet nga nëpunësi i pranimit sipas rregullave në fuqi, i kthehet përsëri aplikuesit.

3. Zyra e regjistrimit:

a) bën ndryshimet në regjistrin elektronik, kartelën përkatëse dhe në programin informatik të mjeteve;

b) plotëson dhe lëshon lejen e re të qarkullimit të mjetit;

c) plotëson dhe lëshon certifikatën e re të pronësisë së mjetit;

d) me dokumentet e dorëzuara krijohet një fashikull, i cili sistemohet në dosjen e mjetit.

4. Ngarkohet DPSHTRR-ja të hartojë rregulla më të hollësishme për procedurat e ndryshimeve konstruktive të mjeteve.

Neni 19

Shënimi i numrit të ri të identifikimit të mjetit

1. Shënimi i numrit të ri të identifikimit të mjetit, bëhet vetëm nga zyra e homologimit pranë DPSHTRR-së e cila lëshon aktin përkatës.

2. Personi i interesuar dorëzon:

a) aplikimin pranë drejtorisë rajonale për shërbimin e kërkuar, i cili përmban dhe deklaratën e marrjes së përgjegjësive administrative, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;

b) aktin e lëshuar mbi numrin e ri të identifikimit të mjetit;

c) lejen e qarkullimit të mjetit;

d) certifikatën e pronësisë së mjetit;

e) kartën e identitetit, e cila pasi fotokopjohet dhe legalizohet nga nëpunësi i pranimit sipas rregullave në fuqi, i kthehet përsëri aplikuesit.

3. Zyra e regjistrimit vepron njëloj si në pikën 3 të nenit 18.

4. Ngarkohet DPSHTRR-ja të hartojë rregulla më të hollësishme, për procedurat e ristampimit, si dhe kodet e numrave që do të ristampohen.

III. HEQJA NGA QARKULLIMI I MJETEVE

Neni 20

Heqja e përkohshme nga qarkullimi i mjeteve

1. Në rastet kur kërkohet çregjistrimi i përkohshëm i mjetit, sipas nenit 9 pika 1 e ligjit nr.9975, datë 28.7.2008 personi i interesuar dorëzon:

a) aplikimin pranë drejtorisë rajonale për shërbimin e kërkuar, i cili përmban dhe deklaratën e marrjes së përgjegjësive administrative, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;

b) lejen e qarkullimit të mjetit;

c) targat e mjetit;

d) kartën e identitetit, e cila pasi fotokopjohet dhe legalizohet nga nëpunësi i pranimit sipas rregullave në fuqi, i kthehet përsëri aplikuesit.

2. Zyra e regjistrimit:

a) bën shënimet në regjistrin elektronik të heqjes së përkohshme nga qarkullimi të mjeteve, sipas modelit të përcaktuar nga DPSHTRR-ja;

b) me dokumentet e dorëzuara, krijohet fashikull, i cili së bashku me targat e mjetit, ruhet në arkiv, në dosarë të veçantë;

c) lëshon dokumentin e çregjistrimit të përkohshëm, sipas modelit të përcaktuar nga DPSHTRR-ja;

d) Njofton sektorin e financës, për çregjistrimin e përkohshëm.

3. Në rastet kur kërkohet reregjistrimi i mjetit, personi i interesuar dorëzon:

a) aplikimin pranë drejtorisë rajonale për shërbimin e kërkuar, i cili përmban dhe deklaratën e marrjes së përgjegjësive administrative, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;

b) dokumentin e çregjistrimit të përkohshëm;

c) kartën e identitetit, e cila pasi fotokopjohet dhe legalizohet nga nëpunësi i pranimit sipas rregullave në fuqi, i kthehet përsëri aplikuesit.

4. Zyra e regjistrimit:

a) bën shënimet në regjistrin elektronik të heqjes së përkohshme nga qarkullimi të mjeteve;

b) dokumentet e dorëzuara i sistemon në fashikullin e krijuar për heqjen e përkohshme të mjeteve nga qarkullimi, të cilin e sistemon në dosjen e mjetit;

c) dorëzon lejen e qarkullimit dhe targat e mjetit.

Neni 21

Heqja e përhershme e mjeteve nga qarkullimi

1. Heqja e përhershme nga qarkullimi bëhet kur mjete:

a) eksportohet;

b) del jashtë përdorimit.

2. Në rastet kur mjete eksportohet, personi i interesuar dorëzon:

a) aplikimin pranë drejtorisë rajonale ku mjete është i regjistruar, për shërbimin e kërkuar, i cili përmban dhe deklaratën e marrjes së përgjegjësive administrative, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;



b) lejen e qarkullimit të mjetit;
c) certifikatën e pronësisë së mjetit;
d) targat e mjetit;
e) kartën e identitetit, e cila pasi fotokopjohet dhe legalizohet nga nëpunësi i pranimit sipas rregullave në fuqi, i kthehet përsëri aplikuesit; Nëse personi është shtetas i huaj, jorezident në Shqipëri, si dokument identifikimi duhet fotokopje e noterizuar e pasaportës dhe, ose e kartës së identitetit.

f) dokumentin e fitimit të pronësisë, kur ka ndryshim pronësie, së bashku me konfirmimin nga Regjistri i Barrëve Siguruese (RBS);

g) kur mjeti i eksportuar është regjistruar në një shtet tjetër, dokumentet sipas shkronjave “b”, “c”, dhe “d”, zëvendësohen me vërtetimin origjinal të regjistrimit të lëshuar nga autoritetet e shtetit që ka bërë regjistrimin, si dhe fotokopjen e dokumenteve të qarkullimit të lëshuara për mjetin.

3. Zyra e regjistrimit:

a) bën shënimet në regjistrin elektronik, kartelën përkatëse dhe në programin informatik të mjeteve;

b) magazinon targat e mjetit;

c) plotëson dhe lëshon lejet e qarkullimit të përkohshme të mjetit, kombëtare dhe ndërkombëtare; Nëse mjeti që eksportohet, do të transportohet i imbarkuar në një mjet tjetër, nuk lëshohet leja e qarkullimit ndërkombëtare.

d) plotëson dhe lëshon certifikatën e re të pronësisë së mjetit, me shënimin “Për eksport”;

e) lëshon targat provizore të mjetit, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.724, datë 1.9.2010;

f) kur ndryshon pronësia, dokumentet lëshohen në emër të pronarit të ri të mjetit;

g) lëshon vërtetimin zyrtar të heqjes së përhershme të mjetit nga qarkullimi, sipas modelit DRM-25, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

4. Kur mjeti del jashtë përdorimit, personi i interesuar dorëzon:

a) aplikimin pranë drejtorisë rajonale për shërbimin e kërkuar, i cili përmban dhe deklaratën e marrjes së përgjegjësive administrative, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;

b) lejen e qarkullimit të mjetit;

c) certifikatën e pronësisë së mjetit;

d) targat e mjetit;

e) kartën e identitetit, e cila pasi fotokopjohet dhe legalizohet nga nëpunësi i pranimit sipas rregullave në fuqi, i kthehet përsëri aplikuesit.

5. Zyra e regjistrimit:

a) bën shënimet në regjistrin elektronik, kartelën përkatëse dhe në programin informatik të mjeteve;

b) me dokumentet e dorëzuara, krijohet një fashikull, i cili sistemohet në dosjen e mjetit;

c) magazinon targat e mjetit;

d) lëshon vërtetimin zyrtar të heqjes së përhershme të mjetit nga qarkullimi, sipas modelit DRM-25, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

KREU II CIKLOMOTORËT

I. REGJISTRIMI I PARË

Neni 22

Shenja e identifikimit të ciklomotorit

1. Për t'u pajisur me shenjën e identifikimit të ciklomotorit, personi i interesuar, që plotëson kushtet sipas nenit 241 të rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor, dorëzon:

- a) aplikimin pranë drejtorisë rajonale për shërbimin e kërkuar, i cili përmban dhe deklaratën e marrjes së përgjegjësive administrative, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;
- b) kartën e identitetit, e cila pasi fotokopjohet dhe legalizohet nga nëpunësi i pranimit sipas rregullave në fuqi, i kthehet përsëri aplikuesit.

2. Zyra e regjistrimit:

- a) plotëson regjistrin elektronik të shenjave identifikuese të ciklomotorit;
- b) hedh të dhënat në programin informatik të mjeteve;
- c) plotëson dhe lëshon menjëherë dëshminë e shenjës identifikuese të ciklomotorit, model DRM-10, bashkëlidhur këtij udhëzimi;
- d) lëshon menjëherë shenjën e identifikimit të ciklomotorit;
- e) me dokumentacionin e dorëzuar, krijohet dosja, e cila sistemohet në arkiv.

Neni 23

Certifikata e përshtatshmërisë teknike Dokumentacioni i nevojshëm për regjistrim

1. Dokumentacioni i nevojshëm për të marrë certifikatën e përshtatshmërisë teknike për ciklomotorët e rinj, të blerë jashtë shtetit:

- a) Dokumenti i fitimit të pronësisë, sipas legjislacionit përkatës me anë të të cilit është fituar pronësia e mjetit.

Me formë të fitimit të pronësisë do të kuptojmë:

- faturë dhe, ose kontratë të fitimit të pronësisë;
- aktin e trashëgimisë për fitimin e pronësisë.

b) Dokumenti teknik i origjinës së ciklomotorit, lëshuar nga prodhuesi ose agjencia e shitjes e ngarkuar prej tij, në origjinal.

c) Dokumenti i zhdoganimit nga autoriteti shqiptar, që nënkuptohet:

- dokumenti administrativ i vetëm DAV në origjinal.

2. Dokumentacioni i nevojshëm për të marrë certifikatën e përshtatshmërisë teknike për ciklomotorët e rinj, të blerë në vend:

a) Dokumenti i fitimit të pronësisë, sipas formës dhe mënyrës që parashikon Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë. Nëse shitësi është subjekt i TVSH-së, si dokument i fitimit të pronësisë duhet edhe fatura me TVSH.

b) Dokumenti teknik i origjinës së ciklomotorit, i lëshuar nga prodhuesi ose agjencia e shitjes e ngarkuar prej tij, në origjinal.

c) Dokumenti i zhdoganimit nga autoriteti shqiptar, si në pikën 1 shkronja "c" të këtij neni.

3. Dokumentacioni i nevojshëm për të marrë certifikatën e përshtatshmërisë teknike për ciklomotorët e përdorur, të blerë jashtë shtetit:

- a) Dokumenti i fitimit të pronësisë, si në pikën 1 shkronja "a" të këtij neni.



b) Dokumentet shoqëruese me treguesit teknikë dhe të pronësisë së mjetit, të lëshuar nga organet zyrtare të shtetit nga vjen mjeti, në origjinal.

c) Dokumenti i zhdoganimit nga autoriteti shqiptar, si në pikën 1 shkronja “c” të këtij neni.

4. Dokumentacioni i nevojshëm për të marrë certifikatën e përshtatshmërisë teknike për ciklomotorët e përdorur, të blerë në vend:

a) Dokumenti i fitimit të pronësisë, sipas formës dhe mënyrës që parashikon Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë. Nëse shitësi është subjekt i TVSH-së, si dokument i fitimit të pronësisë duhet edhe fatura me TVSH.

b) Dokumentet shoqëruese me treguesit teknikë dhe të pronësisë së mjetit, të lëshuara nga organet zyrtare të shtetit nga vjen mjeti, në origjinal.

c) Dokumenti i zhdoganimit nga autoriteti shqiptar, si në pikën 1 shkronja “c” të këtij neni.

5. Personi i interesuar, që do të kuptohet individi, subjekti, ose përfaqësuesi ligjor i tyre, paraqet:

a) aplikimin pranë drejtorisë rajonale për shërbimin e kërkuar, i cili përmban dhe deklaratën e marrjes së përgjegjësive administrative, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;

b) për subjektet, ekstrakt i QKR-së në origjinal dhe autorizim për personin që do të kryejë veprimet, nëse nuk është përfaqësuesi ligjor i subjektit;

c) kartën e identitetit, e cila pasi fotokopjohet dhe legalizohet nga nëpunësi i pranimit sipas rregullave në fuqi, i kthehet përsëri aplikuesit; Për shtetasit e huaj, rezidentë në Shqipëri, duhet leja e qëndrimit e lëshuar nga organet kompetente të Ministrisë së Brendshme, fotokopje e noterizuar.

6. Të gjitha dokumentet e lartpërmendura, që janë në gjuhë të huaj, duhet të jenë të përkthyer në shqip dhe të noterizuara.

7. Zyra e regjistrimit, pasi verifikon dhe mban dokumentet, mbi bazën e tyre:

a) plotëson regjistrin elektronik, kartelën përkatëse dhe hedh të dhënat në programin informatik të mjeteve;

b) plotëson dhe lëshon menjëherë certifikatën e përshtatshmërisë teknike, model DRM-12, bashkëlidhur këtij udhëzimi;

c) me dokumentet e dorëzuara, krijohet dosja e mjetit, e cila sistemohet në arkiv.

II. NDRYSHIMET NË REGJISTËR

Neni 24

Ndryshimi i vendbanimit të personit të pajisur me shenjën e identifikimit të ciklomotorit

1. Kur personi i pajisur me shenjën e identifikimit të ciklomotorit ndryshon vendbanimin, dorëzon në zyrën e regjistrimit të drejtorisë rajonale që ka nën juridiksionin e saj vendbanimin e ri:

a) aplikimin pranë drejtorisë rajonale për shërbimin e kërkuar, i cili përmban dhe deklaratën e marrjes së përgjegjësive administrative, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;

b) dëshminë e shenjës së identifikimit të ciklomotorit;

c) kur pronari ndryshon rrethin e vendbanimit, dorëzon shenjën e identifikimit të ciklomotorit vetëm nëse ajo është sipas sistemit të vjetër;

d) kartën e identitetit, e cila pasi fotokopjohet dhe legalizohet nga nëpunësi i pranimit sipas rregullave në fuqi, i kthehet përsëri aplikuesit.

2. Kur personi i pajisur me shenjën e identifikimit të ciklomotorit, ndryshon vendbanimin brenda rrethit, zyra e regjistrimit:

a) bën ndryshimet në regjistrin elektronik, kartelën përkatëse dhe në programin informatik të mjeteve;

b) me dokumentet e dorëzuara, krijon fashikull, i cili futet në dosjen përkatëse të mjetit;

- c) plotëson dhe lëshon dëshminë e re të shenjës së identifikimit të ciklomotorit.
3. Kur personi i pajisur me shenjën e identifikimit të ciklomotorit, ndryshon vendbanimin brenda rretheve që ka nën juridiksion drejtoria rajonale, zyra e regjistrimit:
- a) bën ndryshimet në regjistrin elektronik, kartelën përkatëse dhe në programin informatik të mjeteve;
 - b) sipas procedurave të miratuara nga DPSHTRR-ja, magazinon shenjën e identifikimit të ciklomotorit, nëse ajo është sipas sistemit të vjetër;
 - c) me dokumentet e dorëzuara, krijon fashikull, i cili futet në dosjen përkatëse të mjetit;
 - d) plotëson dhe lëshon dëshminë e re të shenjës së identifikimit të ciklomotorit;
 - e) i dorëzon aplikantit shenjën e re të identifikimit të ciklomotorit, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.724, datë 1.9.2010 në rastet kur ky i fundit ka pasur shenjë identifikimi të sistemit të vjetër.
4. Kur personi i pajisur me shenjën e identifikimit të ciklomotorit, ndryshon vendbanimin jashtë juridiksionit të drejtorisë rajonale, zyra e regjistrimit:
- a) i bën kërkesë drejtorisë rajonale, ku personi ka qenë i regjistruar më parë, për dërgimin e dosjes;
 - b) bën ndryshimet në regjistrin elektronik, kartelën përkatëse dhe në programin informatik të mjeteve;
 - c) plotëson dhe lëshon dëshminë e re të shenjës së identifikimit të ciklomotorit;
 - d) sipas procedurave të miratuara nga DPSHTRR-ja, magazinon shenjën e identifikimit të ciklomotorit, nëse ajo është sipas sistemit të vjetër;
 - e) i dorëzon aplikantit shenjën e re të identifikimit të ciklomotorit, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.724, datë 1.9.2010, në rastet kur ky i fundit ka pasur shenjë identifikimi të sistemit të vjetër;
 - f) me dokumentet e dorëzuara, krijon fashikull, i cili futet në dosjen e ardhur nga drejtoria rajonale ku personi ka qenë i regjistruar më parë, dhe sistemohet në arkiv.

Neni 25

Ndryshimi i vendbanimit të pronarit të ciklomotorit

1. Kur pronari i ciklomotorit ndryshon vendbanimin, dorëzon në zyrën e regjistrimit të drejtorisë rajonale që ka nën juridiksionin e saj vendbanimin e ri:
 - a) aplikimin pranë drejtorisë rajonale për shërbimin e kërkuar, i cili përmban dhe deklaratën e marrjes së përgjegjësive administrative, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;
 - b) certifikatën e përshtatshmërisë teknike;
 - c) kartën e identitetit, e cila pasi fotokopjohet dhe legalizohet nga nëpunësi i pranimit sipas rregullave në fuqi, i kthehet përsëri aplikuesit.
2. Kur pronari i ciklomotorit ndryshon vendbanimin brenda rrethit, zyra e regjistrimit:
 - a) bën ndryshimet në regjistrin elektronik, kartelën përkatëse dhe në programin informatik të mjeteve;
 - b) me dokumentet e dorëzuara, krijon fashikull, i cili futet në dosjen përkatëse të mjetit;
 - c) plotëson dhe lëshon certifikatën e re të përshtatshmërisë teknike.
3. Kur pronari i ciklomotorit ndryshon vendbanimin brenda rretheve që ka nën juridiksion drejtoria rajonale, zyra e regjistrimit vepron njëjloj si në pikën 2 të këtij neni.
4. Kur pronari i ciklomotorit ndryshon vendbanimin jashtë juridiksionit të drejtorisë rajonale, zyra e regjistrimit:
 - a) i bën kërkesë drejtorisë rajonale, ku personi ka qenë i regjistruar më parë, për dërgimin e dosjes;



- b) bën ndryshimet në regjistrin elektronik, kartelën përkatëse dhe në programin informatik të mjeteve;
- c) plotëson dhe lëshon certifikatën e re të përshtatshmërisë teknike;
- d) me dokumentet e dorëzuara, krijon fashikull, i cili futet në dosjen e ardhur nga drejtoria rajonale ku ciklomotori ka qenë i regjistruar më parë, dhe sistemohet në arkiv.

Neni 26

Ndryshimi i pronësisë së ciklomotorit

1. Kur ndryshon pronësia mbi ciklomotorin, pronari i ri dorëzon në zyrën e regjistrimit të drejtorisë rajonale që ka nën juridiksionin e saj vendbanimin e ri:
